



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Integritime Evropiane  
Mbledhja nr. 16  
Prishtinë, më 15.10.2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**  
**i mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emiri, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbić, ndërsa mungoi Sabri Hamiti.

Pjesëmarrës të tjerë: Michele Dinelli -UNDP, Marie Berisha - OSCE, Fitore Zeneli-KDI, Avni Zuka – NDI, Albinot Bimbashi-ZK-AIE, Mimoza Gojani-ZKM-AIE dhe Lejla Selimi.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe për arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së,**

#### **4. Të ndryshme.**

*Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.*

##### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

##### **2. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe për arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** – E ftoi deputetin Hydajet Hyseni ta paraqesë raportin lidhur me Ligjin nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe për arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

**Hydajet Hyseni** - tha se vazhdimisht i kemi disa probleme nga aspekti i pajtueshmërisë së legjislacionit tonë me *acquis communautaire*. Lidhur me pajtueshmërinë e këtij projektligji është krijuar përshtypja se kjo fushë nuk është e rregulluar me *acquis* komunitare. Kam vërejtur se së paku janë dy akte që e rregullojnë këtë fushë. Njëri është *Joint action 700/a* i datës 3 dhjetor 1998 i adaptuar nga Këshilli i BE-së, që është i bazuar në nenin 3 të Traktatit Evropian dhe ka të bëjë me sistemin e arkivimit dhe të dokumenteve false. Ndoshta vetëm ky aspekt mund të jetë i nevojshëm të krahasohet. Propozoi që me ndihmën e ekspertëve që e mbështesin, Komisioni të punojë dhe në mbledhjen e ardhshme ta paraqesë raportin.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë*

##### **Përfundim**

*Në bashkëpunim me ekspertët Komisioni të punojë për harmonizim e Projektligjit dhe në mbledhjen e radhës të paraqesë raportin lidhur me pajtueshmërinë e Projektligjit me *acquis communautaire*.*

##### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** - I njoftoi anëtarët e Komisionit se duhet të tërhiqet nga rendi i ditës ky projektligj, pasi në leximin e parë nuk është ngarkuar Komisioni për Integritet Evropian si komision kryesor. Propozoi që në Komision të vijnë vetëm projektligje që kanë të bëjnë me harmonizimin e legjislacionit me *acquis communautaire* dhe kështu të përpilohet një listë me projektligje që duhet të harmonizohen.

**Nait Hasani** – Pyeti se cili është qëllimi i organizatave që na mbështesin.

Nëse ato kanë për qëllim të na ndihmojnë lidhur me harmonizimin e legjislacionit, atëherë duhet të na e përgatitin edhe materialin e jo vetëm të na sugjerojnë se si duhet ta bëjmë.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë*

### ***Përfundim***

*Hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me amendamentet e Komisionit Funkcional në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.*

## **4. Të ndryshme**

### **a) Publikimi i buletinit nga NDI-ja**

**Kryesuesja** - Njoftoi se organizata joqeveritare NDI ka propozuar ta publikojë një buletin informativ, me qëllim që ta paraqesë punën e Komisionit.

**Hydajet Hyseni** – Tha: Pasi sot e kemi marrë materialin duhet t'i kemi disa ditë kohë që ta analizojmë, por kam dilemë se cili duhet të bëhet i pari: buletini apo fletëpalosje që do të ishte një ID e Komisionit. Propozoj që për fillim të publikohet fletëpalosja, në të cilën do të përfshiheshin ato që janë paraparë për t'u inkuadruar në buletin, pastaj të publikohet buletini.

**Njomza Emini** – E përkrahu idenë për publikimin e buletinit. Me anë të këtij buletini do të informoheshin më gjerësisht të gjithë të interesuarit për punën e Komisionit dhe do të bëhej pasqyrë e asaj që po e bën ky komision.

**Edita Tahiri** - Tha se është mirë ta kemi një mjet informimi të opinionit për punën e Komisionit, sepse megjithëqë është përgatitur një raport nga ana e Komisionit, nuk është publikuar në të gjitha mediat. Shtoi se marrëdhëniet me publikun janë shumë të rëndësishme. Këtë e shoh si mënyrë për realizimin e marrëdhënieve të tilla. Kërkoi nga deputetët që ishin në Bruksel të paraqesin raport për vizitën e tyre.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë*

### ***Përfundim***

*Të publikohet fletëpalosja në të cilën do të paraqitet puna e Komisionit, pastaj të shqyrtohet mundësia e publikimit të buletinit.*

## **b) Raport për vizitën në Bruksel**

**Kryesuesja** - Tha se e kemi kaluar një ditë në Parlamentin Evropian dhe një ditë në Komisionin Evropian. Vizita në Parlamentin Evropian ka qenë studimore. Aty u informuam për punën, kompetencat dhe për mënyrën e funksionimit të Parlamentit Evropian. Në takimin me Komisionin për Marrëdhënie me Jashtë e kemi pasur mundësinë t'i paraqesim të arriturat dhe vështirësitë tona. Ndër kritikak që na u bënë nga Komisioni Evropian, ka qenë çështja e lobimit. Interesimin më të madh e kanë pasur për përmbushjen e deklaratës së përbashkët, që ishte nënshkruar nga Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë dhe nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës - çështjen e kthimit të refugjatëve serbë dhe për Konferencën e Donatorëve. Për çështjen e kthimit të refugjatëve serbë tha se deputeti Branislav ka bërë një paraqitje shumë reale dhe të frytshme. Njoftoi se në mbledhjen e radhës do të jetë i ftuar ministri i Shërbimeve Publike, në të cilën do të njoftojë se si është e organizuar Zyra e Statistikave, meqë është thënë se nuk ekzistojnë statistika të mirëfillta. Për fund tha, ta presim raportin e progresit që do të dalë në nëntor dhe pastaj të kërkojmë që ky raport të paraqitet në Komision, mandej edhe në seancë plenare.

**Branislav Grbić** - Tha se është hera e parë që kemi marrë pjesë në një takim të rëndësishëm në një organizatë të madhe, siç është Bashkimi Evropian. Duhet të angazhohemi që në punën tonë të ardhshme të jemi seriozë dhe realë. Propozoi që e gjithë puna që bëhet si nga ana e Qeverisë dhe e Kuvendit të jetë serioze dhe në nivel për të mirën e të gjithëve

**Mbledhja përfundoi në orën 11: 30 min.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit**

**Zylfije Hundozi**